

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"ALBMARINE TECHNOLOGY" SHPK**

Sot me daten 14/09/2022 (dymijë e njëzet e dy ), unë ortaku themelues :

- **Z. Urim Vata**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01 Qershor 1979, lindur në Surroj, Kukës, dhe banues në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. H90601200F

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " ALBMARINE TECHNOLOGY" SHPK.*

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " ALBMARINE TECHNOLOGY " SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Ndërtesë 1 katëshe, Autostrada Dr-Tr, km 1 , Lagjja nr 14, Shkozet, Durres,zona kadastrale,8515, nr pasurie 5/2783.

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Prodhim dhe tregti të varkave, zejeve detare, zejeve amfibe, pjesëve, pajisjeve dhe aksesoreve për mjetet detare dhe mjetet amfibe, sediljet e automjeteve, mbulesa anijesh, rimorkio, duke përfshirë rimorkiot e varkave, mekanizma shtytëse për mjete tokësore, anije detare me mekanizma për shtytje dhe udhëtim në tokë, grepa për varkë, byk anijesh, pajisje për lëshimin e varkave, karroca për lëshimin e varkave, predha anijesh, anije për shitje në formë komplete, trupa për varka, bume për varka, transportues për transportin e varkave në automjete, catboats, varka të palosshme, anije konkurimi, davit për varka, gomone për përdorim si varka shpëtimi, pajisje shkëputëse për varkat, dragers (varka), tragetet, anije peshkimi, varka katamarane me asistencë petë, mbulesat e kapakut që janë pjesë strukturore të varkave, kapuç për varka, mënyra të prirura për varkat, varka me fryrje, anije për kohën e lirë, varka shpëtimi, direkë për varka, motobarka, varka me vozitje, anije argëtuese, varka pneumatike, varka me motor; helika për varka, varka me



pneumatike, varka me motor; helika për varka, varka me kanotazh, varka gome, varkat me vela, helika me vida për varka, mbulesa të sediljeve (në formë) për përdorim në varka, jastëkë sediljeje për sediljet e varkave, mbulesa në formë për varkat, anije skijimi, skafe me shpejtësi, anije sportive, varkat me avull, pëlhura gomash të përshtatura (në formë) për përdorim me varka, rimorkio për barka tërheqëse.

Shërbimet me shumicë dhe pakicë, duke përfshirë shitjen me shumicë dhe pakicë të mjeteve detare dhe amfibe, dhe pjesët dhe aksesorët e tyre, duke përfshirë shërbime të tilla të ofruara nëpërmjet internetit, menaxhim biznesi, menaxhimi i një ndërmarrje me pakicë, shitje me pakicë, shumicë dhe eksport të motobarkave luksoze, duke u nisur, shërbime reklamimi dhe marketingu për motobarkat luksoze, duke u nisur, bashkimi për të mirën e të tjerëve të një shumëllojshmërie dizajnesh në lidhje me motobarkat luksoze, duke u lëshuar, duke u mundësuar klientëve të shohin dhe blejnë me lehtësi në linjë nëpërmjet internetit, intraneteve dhe/ose mjeteve të tjera elektronike, ofrimi i shërbimeve të referimit të biznesit (për të tjerët) duke përfshirë programet e besnikërisë në lidhje me shitjen me pakicë dhe/ose tregtimin e motobarkave luksoze, duke u nisur, konsulencë dhe këshillim në lidhje me sa më sipër, ekskluzivitet i sa më sipër. Prodhim bankinash panton beton, shitje ndërtim dhe servisim. Çdo aktivitet tjetër që lejon legjislacioni shqipëtar.

#### **NENI 4** **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "ALBMARINE TECHNOLOGY" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

**1. URIM VATA zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

#### **NENI 5** **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**


Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6** **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. URIM VATA** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakeve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakeve.



Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve,statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjisllacionin tregtar shqipëtar.

#### **NENI 10**

#### **MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
" ALBMARINE TECHNOLOGY" SH.P.K  
URIM VATA**

*urim vata*